

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5683
E mërkurë, 23 janar 2019
çmimi 0.40 €

Vazhdon greva
në arsim | FAQE 11



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**THAÇI: BASHKIMI I QYTETIT
TË MITROVICËS, PROCES
I PANDALSHËM** F. 5

**MUFAL LIMANI ZGJEDHET
USHTRUES DETYRE
I DREJTORIT TË RTK-së** F. 4

**ZYRTARIZOHEN EMËRIMI I
MINISTRIT TË MBROJTJES DHE
KOMANDANTIT TË FSK-së** F. 6

**NË MARS FILLON NDËRTIMI
I TERMOCENTRALIT
'KOSOVA E RE'** F. 7

EKONOMI



**QEVERIA NXJERR
NË SHITJE TELEKOMIN** F. 8

**KËRKOHET NGA FKPK-ja
RRITJE E KUJDESIT
TË MENAXHIMIT TË
KONTRIBUTEVE PENSIONALE** F. 8

KULTURË

POEZIA F. 13

PAL NDRECAJ

SPORT

**TË PREMTEN VENDOSËT E
ARDHMJA E FETAHAJT** F. 15



FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI | FAQE 4-5

ShBA-ja t'i kuptojë drejt reagimet e Kosovës në raport me Serbinë

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka komentuar thirrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shfuqizimin e taksës ndaj produkteve të Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se ShBA-ja duhet t'i kuptojë drejt reagimet e Kosovës në raport me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova nuk ka bërë asnjë veprim të vetëm për t'i prishur raportet me ShBA-në. Sipas Krasniqit, taksa 100 për qind është reagimi më i butë i mundur i Qeverisë së Kosovës. Ai ka theksuar se Kosova duhet të vendosë edhe kushte të reja për Serbinë. Duke folur për ecurinë e dialogut Kosovë - Serbi, Krasniqi ka thënë se Kosova nuk e ka asnjë arsye të vetme të ngutet në këtë proces

Taksa mbetet në fuqi



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se taksa e vendosur ndaj Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës mbetet në fuqi. Ai ka thënë se, pavarësisht prej sugjerimeve të ShBA-së dhe të BE-së, taksa nuk mund të hiqet pa arritjen e marrëveshjes përfundimtare Kosovë -

Serbi. Këto komente Haradinaj i ka bërë të martën në një konferencë për medie, pas takimit të përbashkët me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett dhe kryeparlamentarin Kadri Veseli. Ky i fundit ka thënë se vendimet e institucioneve do të jenë në koordinim me ShBA-në | FAQE 3

Shpëtojnë
110 minatorët
e ngujuar
në horizontet
e 'Trepçës'



FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vite, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania "Jaha Extra Beton" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e parkut të energjisë diellore, projekti "DUKA SONNE"2 në Sverrkë komuna e Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.02.2019 në ora 11:30 në Leshan në restorantin e pikës së karburanteve "Swiss Oil" i cili gjendet në anën e djathtë të magjistrales Prishtinë-Pejë afër fshatit Sverrkë komuna e Pejës, do të organizohet debat publik nga kompania "Jaha Extra Beton" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e parkut të energjisë diellore, projekti "DUKA SONNE"2 në Sverrkë komuna e Pejës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Jep dorëheqje Mitchell, diplomati amerikan i negociatave Kosovë - Serbi



WASHINGTON, 22 JANAR - Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropë dhe Euroazi, Wess Mitchell, të martën i ka dorëzuar dorëheqjen sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, duke thënë se dorëhiqet për arsye personale dhe profesionale. Ky diplomat amerikan ishte i implikuar në të ashtuquajturën marrëveshje finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Mediet amerikane raportojnë se Wess Mitchell diplomati kryesor për çështje evropiane në Departamentin e Shtetit ka dhënë dorëheqje nga detyra e tij, duke i shkaktuar një tronditje të madhe administratës së presidentit

Trump. Në letërën e dorëheqjes, të cilën ia ka dorëzuar Sekretarit Pompeo, Mitchell ka thënë se arsyet janë personale dhe profesionale. Ai më tutje në letër tregon se duhet të vazhdojë aleanca transatlantike, por që po largohet nga detyra për t'iu përkushtuar familjes së tij. Sipas Mitchellit, kjo dorëheqje nuk është protestë ndaj administratës, edhe pse gazeta "Washington Post" e konsideron të tillë, marrë parasysh lëvizjet e fundit të mëdha në administratën e presidentit Trump. Mitchell e ka marrë detyrën e ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit për Evropë dhe Euroazi në shkurt të vitit 2017. Nga ardhja në krye të

kësaj detyre, Mitchell ishte angazhuar për t'i zgjidhur problemet në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke bërë edhe vizita në Prishtinë e Beograd.

Mitchelli e ka përkrahur në emër të qeverisë së tij krijimin e Ushtrisë së Kosovës. Ai konsiderohej nga analistët në Amerikë si kundërshtar i fuqishëm i rritjes së influencës ruse dhe kineze. Mitchell i kishte bërë thirrje Trumpit që të shtohet bashkëpunimi i shteteve të NATO-s që të parandalohet rritja e influencës ruse. Mbetet e paqartë se kush do të vijë në vend të tij dhe se si do të rrjedhin bisedat në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Meta: Shqiptarët të përfshihen më shumë në institucionet shtetërore në Mal të Zi

Në takim me kryeministrin malazias Dushko Marković, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, kërkoi një përfaqësim më përfshirës dhe më të drejtë të shqiptarëve në institucionet qendrore dhe lokale të Malit të Zi.



PRISHTINË, 22 JANAR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, u prit të martën në takim nga kryeministri i Malit të Zi, Dushko Marković, në ditën e dytë të vizitës shtetërore në shtetin fqinj. Gjatë takimit, presidenti apeloi për një përfaqësim më përfshirës dhe më të drejtë të shqiptarëve në institucionet qendrore dhe lokale të Malit të Zi.

Presidenti Meta përgëzoi kryeministrin Marković për përparimin që ka shënuar Malit të Zi, veçanërisht sa i përket procesit të integritetit evropian, aq jetik për të gjitha vendet e rajonit. Gjatë takimit presidenti Meta shprehu dëshirën që bashkëpunimi i mirë që ekziston midis dy vendeve të

përshejtohet dhe të thellohet më tej në të gjitha fushat, duke pasur si objektiva parësor ndërlidhjen gjithnjë e më të mirë mes qytetarëve në të dyja anët e kufirit. Meta inkurajoi përcaktimin e prioritetëve të qarta dhe ndjekjen e projekteve konkrete në fushën e infrastrukturës, mjedisit, ujërave, turizmit etj., që i japin përmbajtje dhe shprehin vullnetin e ndërsjellë politik për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

Presidenti Meta theksoi se partneriteti në NATO duhet të

frymëzojë marrëdhënie më të ngushta dhe të afërta ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe se të dy qeveritë i kanë të gjitha mundësitë ta modelojnë këtë bashkëpunim në përcim të vlerave më të mira të Aleancës. Nga ana e tij, kryeministri i Malit të Zi, Marković, e informoi presidentin Meta për disa projekte konkrete në mbështetje të zonave ku banojnë shqiptarë, siç është ndërtimi i rrugës Tuz-Grabon, rikonstruksioni i shkollës së fshatit Dacaj në Rozhajë, përmirësimi i infra-

Meta takon liderët shqiptarë

Presidenti Ilir Meta zhvilloi edhe një takim me përfaqësuesit kryesorë të partive politike shqiptare në qytetin e Tuzit, kreun e Aleancës Shqiptare, Nik Gjelloshaj, kreun e Lidhjes Demokratike Shqiptare, Nikollë Camaj, kryetarin e Unionit Demokratik Shqiptar-Tuz, Fadil Kajoshaj, e figura të tjera politike. Meta u njoftua prej tyre me zhvillimet më të fundit për përgatitjet e zgjedhjeve vendore në këtë komunë që do të mbahen më 3 mars 2019 dhe koalicionin e arritur mes disa subjekteve politike shqiptare. Presidenti Meta u bëri thirrje partive politike shqiptare që ta maksimalizojnë votën e tyre dhe t'i përafrojnë qëndrimet në mënyrë që

në Komunën e Tuzit të fitojnë një shumicë që mundëson krijimin e qeverisjes vendore nga ana e shqiptarëve në koalicion me subjektet e tjera. "Është kënaqësi e veçantë që vizitoj Tuzin, njëkohësisht dua t'ju uroj një vit të ri sa më të mbarë. Ju jeni në prag të zgjedhjeve që do të zhvillohen së shpejti në Komunën e Tuzit. Ju uroj suksese të gjithë juve që merrni pjesë në këtë garë elektorale, që jo vetëm të kontribuoni për ta përmirësuar qeverisjen vendore këtu por, njëkohësisht, për t'i treguar aftësitë drejtuese të shqiptarëve të Tuzit përmes bashkëpunimit dhe përmes bashkëjetesës me malazezët dhe me të gjitha grupet e tjera", tha Meta.

strukturës rrugore në Plavë dhe Guci, hapja e disa pikave kufitare në këtë zonë si dhe në Ulqin, punësimi i shqiptarëve në institucionet qendrore dhe lokale etj. Presidenti Meta shprehu kënaqësinë që faktori shqiptar

në Mal të Zi vazhdon të kontribuojë pozitivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha proceset demokratizuese dhe zhvillimore, duke qenë faktor kyç për qasjen euroatlantike dhe evropiane të vendit.

Ligji për gjuhët në Maqedoni dërgohet në Komisionin e Venecias

SHKUP, 22 JANAR - Qeveria e Maqedonisë ka dërguar në Komisionin e Venecias përmbajtjen e plotë të Ligjit për gjuhët bashkë me tekstin alternativ të nenit 8 dhe tri dispozitat e tij që kanë të bëjnë me shqipen në bankënota,

letrat me vlerë dhe uniformat e ushtrisë dhe policisë. Në letër thuhet që Qeveria pret vlerësim për aspektet e pajtimt të ligjit me standardet evropiane dhe principet e sundimit të ligjit. Gjithashtu, është theksuar se Ligji i

gjuhëve rrjedh nga Marrëveshja e Ohrit dhe se qëllimi i tij është që të krijojë kornizë të harmonizuar juridike në dispozita ligjore dhe që do të harmonizohet pa cenuar Kushtetutën e Maqedonisë.



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, është pritur në takim të përbashkët nga kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj

Taksa mbetet në fuqi

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se taksa e vendosur ndaj Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës mbetet në fuqi. Ai ka thënë se, pavarësisht prej sugjerimeve të ShBA-së dhe të BE-së, taksa nuk mund të hiqet pa arritjen e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. Këto komente Haradinaj i ka bërë të martën në një konferencë për medie, pas takimit të përbashkët me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett dhe kryeparlamentarin Kadri Veseli. Ky i fundit ka thënë se vendimet e institucioneve do të jenë në koordinim me ShBA-në

amerikan biseda ishte dialogu i ndërlidhur edhe me taksën e vendosur nga institucionet e Kosovës dhe mundësitë për të ardhmen që të arrihet një avancim në dialog. Kjo ishte biseda. Nuk ka ndryshim të madh. Edhe ne kemi dëshirë ta heqim taksën dhe synojmë ta heqim atë, sepse është edhe sugjerim i aleatëve tanë, pra i ShBA-së, por e ndërlidhim heqjen e saj me një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë për njohje reciproke", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se janë rritur presionet për heqjen e taksës. Mirëpo Haradinaj ka thënë se Kosova nuk është më ai vendi të cilit duhet t'i tregojnë se çfarë duhet të bëjë. Sipas tij, vendimi për taksën është vetëm i Kosovës dhe ai mund të mbetet përgjithmonë. "Nuk është më ajo Kosova që i tregon se çfarë duhet të bëjë.

Ne jemi të pavarur, sovran dhe marrim vendime vetë. Taksa mund të mbetet edhe përgjithmonë, mirëpo ne jemi të interesuar ta heqim, por jo siç mendojnë disa", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se taksa hiqet vetëm me vendim të Qeverisë dhe nuk ka mundësi ndryshe. Madje ai ka thënë se tash po shfaqen ide dhe sugjerime të ndryshme nga disa parti dhe, siç ka thënë Haradinaj, "janë lig dhe po mundohen të prijnë para temave". Ndërsa nikoqiri i takimit, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, e ka quajtur konstruktiv takimin e së martës, duke thënë se vendimet e institucioneve të Republikës së Kosovës do të jenë në koordinim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai ka bërë me dije se Kosova është e vendosur që

përjetësisht ta ruajë miqësinë dhe partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, sipas Veselit, kjo nuk do të ndryshojë asnjëherë. "Me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett dhe kryeministrin Ramush Haradinaj sot patëm një takim tejet konstruktiv dhe diskutuam për sfidat që na presin gjatë këtij viti. Ne do të punojmë bashkë që vendimet e institucioneve të Kosovës, për procese të rëndësishme, të jenë në interes të qytetarëve tanë dhe në koordinim të plotë me ShBA-në dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë. Kosova është e vendosur që përjetësisht ta ruajë miqësinë dhe partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kjo nuk do të ndryshojë asnjëherë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 22 JANAR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nuk po arrijnë ta bindin Republikën e Kosovës për ta pezulluar taksën ndaj produkteve serbe. Në këtë drejtim nuk ka pasur sukses as takimi i përbashkët në mes të ambasadorit amerikan Philip Kosnett me kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe kryeministrin Ramush Haradinaj i cili është mbajtur të martën pa praninë e medieve në kabinetin e kryetarit të Kuvendit. Pas këtij takimi kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se taksa e vendosur ndaj Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës mbetet në fuqi. Në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë, kryeministri Haradinaj ka thënë se dëshiron që t'i dëgjojë sugjerimet dhe thirrjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian për shfuqizimin e taksës, por vendimi për heqjen e saj nuk mund të merret

pa arritjen e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. "Takimi ishte thirrur nga kryeparlamentari Kadri Veseli. Në takimin me ambasadorin



Thaçi udhëton për në Davos, merr pjesë në Forumin Ekonomik Botëror

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka udhëtuar për në Davos të Zvicrës, ku bashkë me liderë nga mbarë botë do të marrë pjesë në Forumin Ekonomik Botëror. Gjatë qëndrimit në Davos, presidenti Thaçi do të zhvillojë takime të shumta me përfaqësues të shteteve të ndryshme të botës

për t'i thelluar marrëdhëniet bilaterale. Po ashtu, presidenti Thaçi do të zhvillojë takime edhe me përfaqësues të Bashkimit Evropian, nga të cilët do ta kërkojë përsheptimin e agjendës evropiane për Kosovën. Ky forum i përvitshëm mbledh në Davos rreth 3 000 liderë shtetërorë, përfaqësues të bizneseve, të organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile.



Flet për "Epokën e re", Jakup Krasniqi

ShBA-ja t'i kuptojë drejt reagimet



Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka komentuar thirrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shfuqizimin e taksës ndaj produkteve të Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se ShBA-ja duhet t'i kuptojë drejt reagimet e Kosovës në raport me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova nuk ka bërë asnjë veprim të vetëm për t'i prishur raportet me ShBA-në. Sipas Krasniqit, taksa 100 për qind është reagimi më i butë i mundur i Qeverisë së Kosovës. Ai ka theksuar se Kosova duhet të vendosë edhe kushte të reja për Serbinë. Duke folur për ecurinë e dialogut Kosovë - Serbi, Krasniqi ka thënë se Kosova nuk e ka asnjë arsye të vetme të ngutet në këtë proces

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 JANAR - Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) duhet t'i kuptojnë drejt reagimet e Kosovës në raport me Serbinë. Ai ka mohuar mundësinë që taksa ndaj produkteve serbe

mund të ndikojë në raportet e mira Kosovë - ShBA. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës ka deklaruar se taksa prej 100 për qindësh është reagimi më i butë i mundur i Qeverisë së Kosovës. "Kosova nuk ka bërë asnjë veprim të vetëm për t'i prishur raportet me ShBA-në. ShBA-ja duhet t'i kuptojë drejt reagimet e Kosovës në

Mufail Limani zgjedhet ushtrues detyre i drejtorit të RTK-së

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) në mbledhjen e mbajtur të martën ka zgjedhur ushtrues detyre të drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, Mufail Limanin. Në njoftimin për medie të Bordit të

RTK-së është bërë me dije se këtë funksion Limani do ta ushtrojë deri në zgjedhjen e drejtorit të ri të përgjithshëm të RTK-së, por jo më shumë se gjashtë muaj, ashtu siç është e përcaktuar me statutin e RTK-së. "Një vendim të tillë

Bordi i RTK-së e ka marrë duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me Ligjin dhe Statutin e RTK-së. Limani do ta ushtrojë detyrën e drejtorit të përgjithshëm duke filluar nga data 28. 1. 2019, pasi drejtorit

aktual, Mentor Shalës, i skadon mandati më 27 janar 2018", është thënë në njoftimin e Bordit të RTK-së. Mufail Limani deri më tani ka ushtruar pozitën e zëvendës-drejtorit të përgjithshëm të RTK-së.



e Kosovës në raport me Serbinë



"Epoka e re": Z. Krasniqi, kemi një kërkesë të vazhdueshme të ShBA-së për ta tërhequr taksën ndaj produkteve serbe. Si duhet të veprojë Kosova në këtë rast?

Krasniqi: Pa asnjë dyshim, ShBA-ja për Kosovën ka pasur dhe ka rëndësi të madhe, por shqiptarët e kanë përgjegjësinë për ta ndërtuar shtetin e së drejtës, shtetin ku duhet të sundojnë rendi dhe ligji. Shqiptarët duhet t'i ndërtojnë raportet e partneritetit me shtetet fqinje. Kosova nuk mban asnjë përgjegjësi për raportet e tilla që i ka me Serbinë, pasi gjatë këtyre 20 vjetëve është përpjekur dhe ka bërë shumë kompromise për të ndërtuar raporte të reja të ndërsjella, por Serbia as ishte e as është e gatshme ta njohë Kosovën dhe të ndërtojë marrëdhënie normale reciproke.

"Epoka e re": Sa po i rrezikon Kosova raportet me Amerikën, nëse nuk e heq taksën?

Krasniqi: Kosova nuk ka bërë asnjë veprim të vetëm për t'i prishur raportet me ShBA-në. ShBA-ja duhet t'i kuptojë drejt reagimet e Kosovës në raport me

Serbinë. Taksa 100 për qind është reagimi më i butë i mundur i Qeverisë së Kosovës. Kosova duhet të vendosë edhe kushte të reja për Serbinë.

"Epoka e re": Kosova po hynë në fazën finale të dialogut me Serbinë pa një konsensus kombëtar. A është e gatshme Kosova për këtë fazë të dialogut?

Krasniqi: Mosekzistimi i konsensusit kombëtar për asnjë gjë, është përgjegjësi e politikës sonë. Tani kjo përgjegjësi është tek opozita e tashme. Kosova gjatë gjithë këtyre viteve ishte e gatshme për ta përmbyllur dialogun, por kjo as është varur e as nuk varet nga Kosova. Kosova nuk ka çfarë t'i japë Serbisë, bile ka dhënë shumë deri më tani. Kosova duhet të mendojë për zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë, për drejtësinë dhe sigurinë kombëtare etj.

"Epoka e re": Dy subjektet më të mëdha opozitare po e kundërshojnë këtë proces. Si e keni parë qëndrimin e tyre?

Krasniqi: Partitë politike formohen për të qenë në shërbim të kombit

e të shtetit dhe jo kombi e shteti në shërbim të partive politike. Partitë politike i kanë qëllimet e tyre. Varet nga to se cilat janë qëllimet e tyre, çka ato kanë vënë në krye të piramidës së tyre politike për shtetin, interesin partiak apo atë shtetëror e kombëtar.

"Epoka e re": Po thuhet se tani është çasti më i mirë për një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë. A duhet të ngutet Kosovë në këtë drejtim?

Krasniqi: Çasti më i mirë për një marrëveshje është kur të dyja palët e kanë gatishmërinë për marrëveshje politike për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore. Kosova nuk e ka asnjë arsyeje të vetme që të ngutet në këtë proces. Kosova nuk ka çfarë t'i japë Serbisë. Serbia ka shumë faje në raport me Kosovën dhe shqiptarët. Serbia do të duhej ta kërkonte dorën e pajtimit dhe jo e kundërta. Çështja më e ngutshme që e ka Kosova është krijimi i perspektivës për qytetarët e saj. Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi do të duhej t'i ngutej Serbisë e jo Kosovës.

Thaçi: Bashkimi i qytetit të Mitrovicës, proces i pandalshëm

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar të martën me kryetarin e Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, me të cilin ka diskutuar për iniciativën për bashkimin e qytetit të Mitrovicës. "Bashkimi i qytetit të Mitrovicës është proces i pandalshëm. Në takim me kryetarin Bahtiri konstatoam se qytetarët e Mitrovicës e kanë thënë fjalën e tyre. Tani e kanë radhën të veprojnë institucionet:

Qeveria, Kuvendi dhe Presidenca", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Më 16 janar Agim Bahtiri ia ka dorëzuar peticionin me 16 594 nënshkrime të qytetarëve për bashkimin e qytetit të Mitrovicës, kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit. Me këtë rast ai ka kërkuar nga institucionet e Kosovës t'i ndërmarrin procedurat e nevojshme ligjore për realizimin e vullnetit të qyte-

tarëve për bashkimin e Mitrovicës. Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Mitrovica do të mbetet për jetë e Kosovës dhe se peticioni do të trajtohet në mënyrë shumë serioze. Peticioni për bashkimin e qytetit të Mitrovicës ka filluar në fund të vitit të kaluar dhe brenda shtatë ditësh janë mbledhur gjithsej 16 594 nënshkrime nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.



raport me Serbinë. Taksa 100 për qind është reagimi më i butë i mundur i Qeverisë së Kosovës. Kosova duhet të vendosë edhe kushte të reja për Serbinë", ka thënë Krasniqi. Ai ka deklaruar se ShBA-ja për Kosovën ka pasur dhe ka një rëndësi të madhe por, sipas tij, shqiptarët e kanë përgjegjësinë për ta ndërtuar shtetin e së drejtës. "Shqiptarët duhet t'i ndërtojnë raportet e partneritetit me shtetet fqinje. Kosova nuk mban asnjë përgjegjësi për raportet e tilla që i ka me Serbinë, pasi gjatë këtyre 20 vjetëve është përpjekur dhe ka bërë shumë kompromise për të ndërtuar raporte të reja të ndërsjella, por Serbia as ishte e as është e gatshme ta njohë Kosovën dhe të ndërtojë marrëdhënie normale reciproke", është shprehur Krasniqi.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës

ka folur edhe për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se mosekzistimi i konsensusit kombëtar për këtë fazë të dialogut është përgjegjësi e politikës sonë. Krasniqi ka vlerësuar se në këtë fazë Kosova nuk ka çfarë t'i japë Serbisë. "Tani kjo përgjegjësi është tek opozita e tashme. Kosova gjatë gjithë këtyre viteve ishte e gatshme për ta përmbyllur dialogun, por kjo as është varur e as nuk varet nga Kosova. Kosova nuk ka çfarë t'i japë Serbisë, bile ka dhënë shumë deri më tani. Kosova duhet të mendojë për zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë, për drejtësinë dhe sigurinë kombëtare etj", ka thënë Krasniqi. Më tej, ai ka bërë me dije se Kosovës nuk duhet t'i ngutet për këtë fazë të dialogut. Sipas tij, normalizimi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi do të duhej t'i ngutej Serbisë e jo Kosovës.

Haradinaj: Jemi në fazën finale të liberalizimit të vizave

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 JANAR - Të martën është mbajtur takimi i nivelit të lartë për sundim të ligjit, në të cilin janë shqyrtuar pako të ligjeve antikorupsion dhe rastet e shënjestruara. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe diplomatët e huaj në Kosovë. Përkrah kryeministrit Ramush Haradinaj në këtë takim ishin ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, dhe shefja e Zyrës së BE-së, Nataliya Apostolova. Kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova tashmë është në një fazë ku duhet t'i shtojë përpjekjet për ta unifikuar agjendën për integrim. "Jemi në fazën finale të liberalizimit të vizave", është shprehur kryeministri. Ai ka

thënë se zhvillimi ekonomik, si fokus qeveritar për vitin 2019, është i lidhur ngushtë me sundimin e ligjit dhe ndjekjen e veprave penale që pengojnë këtë zhvillim. "Kosova ka hapur dyert për investitorë të huaj dhe ka avancuar në garantimin e sigurisë së kapitalit të tyre. Kemi forcuar policinë, prokurorinë dhe gjykatat. Kemi ndryshuar dhe forcuar ligjet që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Të gjitha këto investime si adresë e kanë shtetin dhe nuk do të lejojmë pengesa korruptive. Kosova ka kapacitete dhe guxim për t'u ballafaquar me raste komplekse dhe do të ndërmarrë çdo veprim që askush të mos jetë mbi ligjin", ka thënë Haradinaj.



Hoxhaj: Forcimi i sigurisë së brendshme, prioritet i Qeverisë



PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka marrë pjesë të martën në takimin përmbyllës të projektit të dytë të binjakëzimit "Përkrahja e mëtejme e arsimit të sigurisë publike në Kosovë", të mbështetur nga Bashkimi Evropian, që u mbajt në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se institucionet e sigurisë, veçmas policia dhe doganat, janë prej sukseseve më të mëdha të shtetit të ri të Kosovës. Ai ka theksuar se sukseset në këtë sektor nuk do të mund të arriheshin pa mbështetjen e shteteve mike

që përkrahën ngritjen profesionale dhe zhvillimin e kapaciteteve për luftimin e kriminalitetit, përgatitjen e pjesëtarëve të institucioneve të sigurisë e deri te themelimi dhe forcimi i institucioneve përkatëse. "Jam këtu për të falënderuar, në emër të Qeverisë së Kosovës dhe të qytetarëve, secilin shtet veç e veç, si dhe Bashkimin Evropian. Ne asnjëherë nuk do të ndalemi së forcuari kapacitetet për ta rritur profesionalizmin në luftimin e krimit dhe korrupsionit", ka deklaruar zëvendëskryeministri Hoxhaj. Ai ka treguar se një nga përpjekjet e vazhdueshme të

Kosovës është forcimi i sigurisë së brendshme. "Në një botë të ndryshimeve është jetike të mbrohet pavarësia dhe siguria e Kosovës. Për një shtet të ri si ne, është me rëndësi të jetë e qartë se siguria, mbrojtja dhe politika e jashtme nuk duhet të jenë të veçuara nga njëra-tjetra", është shprehur Hoxhaj, duke shtuar se institucionet e sigurisë sot reflektojnë edhe një të arritur tjetër, atë çfarë është Kosova në vitin 2019, karakterin shumetnik dhe pjesëmarrjen e madhe të grave pothuajse në të gjitha strukturat, duke përfshirë edhe ato të larta drejtuese e të menaxhmentit.



Zyrtarizohen emërimi i ministrit të Mbrojtjes dhe komandantit të FSK-së

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Pas votimit të tre projektligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, nënshkrimi nga presidenti Hashim Thaçi, si dhe pas publikimit në Gazetën Zyrtare më 21 janar, solemnisht u bë zyrtarizimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe procesi i tranzicionit të FSK-së në ushtri të Kosovës si dhe emërimi i ministrit të Mbrojtjes dhe komandantit të FSK-së.

ka emëruar ministër të Mbrojtjes Rustem Berishën. Vendimi ka hyrë në fuqi më 20 janar. Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka emëruar zyrtarisht komandant të FSK-së gjenerallejtnant Rahman Ramën me mandat pesëvjeçar. Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtnant Rahman Rama, u betua para presidentit të Republikës, Hashim Thaçi, se do të vazhdojë t'i shërbejë atdheut dhe mbrojtjes së qytetarëve tanë.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhja e saj të radhës

Në mars fillon ndërtimi i termocentralit 'Kosova e Re'

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se në mars të këtij viti pritet të fillojë ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re". Pas mbledhjes së kabinetit qeveritar, ai ka treguar se tashmë janë informuar nga kompania fituese "Contour Global", se ka siguruar mjetet e nevojshme për realizimin e projektit në vlerë mbi 1.3 miliard euro përmes së cilit Kosova synon stabilizimin e situatës me energji elektrike. Haradinaj ka thënë se ky investim do të sjellë një revolucion në rritje ekonomike deri në 7 për qind

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 JANAR- Ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re" pritet të fillojë në muajin mars të këtij viti. Kështu ka bërë me dije kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një konferencë me gazetarë pas mbledhjes së kabinetit qeveritar.

Ai ka thënë se janë informuar nga kompania fituese "Contour Global", se ka siguruar mjetet e nevojshme për realizimin e projektit në vlerë mbi 1.3 miliard euro.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se ky investim do të sjellë një revolucion në rritje ekonomike i cili do të arrijë deri në 7 për qind. Ai e ka falënderuar kompaninë "Contour Global" për angazhimin

e deritashëm duke thënë se Kosova është e kënaqur me kontratën e ndërtimit të termocentralit të ri, por Haradinaj ka kërkuar nga kjo kompani që të angazhojë sa më shumë kompani vendore në realizimin e këtij termocentrali. "Një lajm i veçantë për sot është se investimi më i madh që nga paslufta në vlerë prej 1.3 miliard e ka pa dritën. Është lajm i mirë për Kosovën që projekti është në fazën më serioze tani dhe njoftimi që në muajin shkurt përcaktoheni për propozimet edhe teknike dhe financiare dhe në muajin mars edhe fillojnë punët e para. Kjo është dëshmia më e mirë. Ne kemi besim në ju si investitorë dhe jemi krenarë me kontratën që ka Kosova me ju. Falënderoj të gjitha institucionet e vendit, deputetët, partitë politike

dhe qeveritë para meje, Qeverinë Mustafa, sepse edhe ajo ka pasur kontribut në përgatitje të këtij projekti. Ky investim do të sjellë një revolucion në rritje ekonomike, i cili do të arrijë deri në 7 për qind", ka theksuar Haradinaj.

Në mbledhjen e së martës Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm, i cili synon funksionalizimin e institucionit përgjegjës për politikën e jashtme dhe shërbimin diplomatik-konsullor.

Ky projektligj është fuzionim i tri ligjeve që më herët kanë rregulluar këtë fushë, me që zhvillimet e reja e kanë shtruar nevojën e përshtatjes së legjislacionit në fushën e shërbimit të jashtëm.

Aprovimin e qeverisë e ka marrë edhe vendimi për miratim të nismës për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për heqjen graduale të kontrolleve në kufirin e përbashkët.

Gjithashtu qeveria në këtë mbledhje ka aprovuar edhe Projektligjin për pronën publike. Çështjet kryesore të trajtuara në këtë projektligj kanë për qëllim rregullimin e të drejtës pronësore publike dhe të drejtave tjera pronësore të Republikës së Kosovës dhe të njësisve të vetëqeverisjes lokale. Ky Projektligj siguron përkufizimin standard të pronës publike, format e pronës publike dhe rreg-

ullon çështjet që kanë të bëjnë me disponimin, shfrytëzimin, menaxhimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen, vlerësimin dhe evidentimin e pronave publike.

Me propozim të zëvendëskryeministrit Enver Hoxhaj qeveria ka aprovuar vendimin për mbështetjen e Klubit të Prodhuesve Kosovarë me 35 mijë euro për implementimin e fushatës vetëdijësuese për prodhimet vendore dhe për konsumin e tyre. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica ka kërkuar nga kabineti qeveritar që sa më parë të procedojë me miratimin e Projektligjit për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror që do t'i hapte rrugë funksionalizimit të Ligjit për punë.

21 vjet nga sulmi i dytë ndaj familjes Jashari

Në orët e hershme të mëngjesit të 22 janarit të vitit 1998, nga Fabrika e Municionit, rreth 500 metra larg lagjes Jashari në Prekaz, forca të policisë serbe u nisën drejt Kullës së Jasharëve për ta sulmuar me armë të llojeve të ndryshme

SKENDERAJ, 22 JANAR (ER) - Të martën u bënë 21 vjet që nga sulmi i dytë nga forcat serbe ndaj familjes Jashari. Ky sulm nuk ishte i rastësishëm pasi që shërbimi sekret serb kishte identifikuar kullën e Jasharëve në Prekaz si një nga pikat më të forta të rezistencës që atë kohë kishte filluar të merrte përmasa në gjithë Kosovën.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se 21 vjet më parë familja Jashari u sulmua për herë të dytë brenda pak muajsh, nga forca të shumta policore serbe, të pozicionuara në ish-Fabrikën e Municionit, pak metra larg shtëpive të familjes Jashari.

Ai ka thënë se, pavarësisht prej një aksioni policor që kishte ndodhur në orët e hershme të mëngjesit të 22 janarit të vitit

1998, në një sulm tinëzar, ku mbeten të plagosura vajza e Rifatit, Iliriana dhe Hamzës, Selvetja, meshkujt e familjes, por edhe anëtarë të tjerë, iu kishin përgjigjur në të njëjtën mënyrë krismave të armikut. "Pas kësaj ngjarjeje, familja e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, e kishte të qartë se forcat policore serbe herët a vonë do të ktheheshin përsëri në Prekaz. Dhe, më 5, 6 dhe 7 mars të po atij viti, historia do të ndryshojë përgjithmonë. Pjesa tjetër e historisë është lavdia e popullit shqiptar. Qoftë i përjetshëm kujtimi për familjen Jashari, heronjtë dhe martirët e Kosovës", ka thënë kryetari Jashari.

Edhe presidenti Hashim Thaçi ka thënë se sulmet e vazhdueshme



mbi familjen Jashari, e cila dallohej për atdhetarizëm dhe veprime të guximshme kombëtare, ishin paralajmërim se Serbia po përgatitej ta shtypte me dhunë çdo familje liridashëse në Kosovë. Ai

ka thënë se familja Jashari, me idealizëm dhe ndërgjegje të lartë njerëzore, politike e kombëtare, asnjëherë nuk ndaloi së sakrifikuari për liri dhe pavarësi. "Historitë e popujve kanë rrëfime

të ndryshme për shumë heronj, por komandanti Adem Jashari dhe familja e tij janë shembulli më unik i atdhetarizmit dhe vetëmohimit për lirinë e një populli", ka thënë presidenti Thaçi.

Komisioni e kthen prapa draftstatutin e 'Trepçës'



Në Kuvendin e Kosovës të martën është mbajtur mbledhja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, në të cilën është shqyrtuar draftstatuti i ndërmarrjes "Trepça". Në këtë mbledhje është vendosur që të kthehet prapa ky draftstatut dhe të sillet i kompletuar në kontekstin e harmonizimit të kërkesave me sindikatën

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 JANAR - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal ka kthyer prapa projektstatutin e "Trepçës" pas vërejtjeve që dhanë deputetët e këtij komisioni. Deputetët kërkuar nga

Bordi i "Trepçës" që të sjellë para tyre një dokumentacion të plotë dhe të harmonizuar me kërkesat e sindikatës.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosjes, Liburn Aliu, ka deklaruar se ky statut është i njëjtë me atë që ka qenë më parë. "Le ta bëjë bordi statutin. Nëse na i shtimë duart në statut atëherë në hyjmë në një grup të

gjerë heterogjen, ku edhe mund të bëhen gabime. Pse ne të bëjmë amendamente?", është shprehur ai.

Kurse kryetarja e këtij komisioni, Sala Berisha-Shala, ka deklaruar se Kuvendi miraton edhe statute. Sipas saj, zërat kundërshtarë nuk ia duan të mirën as "Trepçës" dhe as vendit.

Edhe deputetja e LDK-së,

Hykmete Bajrami, është shprehur e pakënaqur me draftstatutin e marrë. Ndërsa deputeti i PSD-së, Dardan Sejdiu, ka dhënë vërejtje për draftstatutin aktual. "Nëse shkojmë faqe për faqe, shohim se nuk ka përputhje në mes të shtyllave", ka thënë Sejdiu.

Deputeti i AAK-së, Muharrem Nitaj, ka pyetur anëtarët e bordit të "Trepçës" pse nuk kanë sjellë një draftstatut të plotë. Në përgjigjen e tij, anëtari i bordit, Naser Peci, ka theksuar se është e vështirë për t'u përfshirë të gjitha në një draft-statut, mirëpo ka pohuar se kolona e

tretë është shumë e përafërt me atë që është arritur marrëveshja.

Kryetari i Sindikatës së "Trepçës", Shyqiri Sadiku, ka rikonfirmuar harmonizimin e kërkesave të tij, duke theksuar se për krejt këto zvarritje përgjegjës është bordi i sindikatës pasi, sipas tij, nuk ka pranuar t'i vendosë në statut vërejtjet që sindikata ua ka dhënë. Po në këtë mbledhje u vendos që raporti i panelit për zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it t'i kalojë Kuvendit që të zgjedhë gjashtë anëtarë, nga 12 sa janë në listën e gushtë.

Qeveria nxjerr në shitje Telekomin



PRISHTINË, 22 JANAR - Qeveria e Kosovës ka miratuar të martën një kërkesë të prezantuar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka,

për përgatitjen e Telekomit të Kosovës për privatizim. Lluka ka thënë se ka kërkuar nga BERZH-i që ta ndihmojë Qeverinë e Kosovës ta

ristrukturojë Telekomin e Kosovës me qëllim të përmirësimit të performancës së kësaj ndërmarrje. Ai ka thënë se BERZH-i ka ofruar

gatishmërinë për të ofruar një kredi deri në 25 milionë euro për ta ndihmuar përgatitjen e Telekomit për privatizim. "Kërkoj që të miratohet

kërkesa e komisionit për ndërmarrje publike që të autorizohet komisioni për privatizim të Telekomit", ka thënë ministri Lluka.

Shpëtojnë 110 minatorët e ngujuar në horizontet e 'Trepçës'

Të martën rreth orës 12:00 ka ndodhur një shpërthim i zjarrit në trafostacionin e ndërmarrjes "Trepça" në Mitrovicë, përkatësisht në minierën e Stantërgut, ku kanë mbetur të ngujuar rreth 110 minatorë. Pas intervenimeve të ekipeve të shpëtimit, minatorët kanë dalë nga horizonti pa ndonjë lëndim trupor. Ata ishin ngujuar në një thellësi prej 840 metrash



**EPOKA
ERE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 JANAR - Të martën rreth orës 12:00 ka ndodhur një shpërthim në një trafo eklektike që furnizon minierën e kompleksit metalurgjik "Trepça" në Stantërg. Si rrjedhojë e këtij zjarri në minierën e Stantërgut mbetën të ngujuar rreth 110 minatorë ku, falë ndihmës së emergjencave, të gjithë dolën nga horizonti pa ndonjë lëndim trupor. Ata ishin ngujuar në një thellësi të tokës prej 840 metrash, pas një avarie në sistemin elektrik të ndërmarrjes. Fillimisht lajmin për gazetën "Epoka e re", gjatë ditës së martë, e ka konfirmuar ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues të ndërmarrjes "Trepça", Xhevdet Tahiri. Ndërkaq kryesuesi i bordit të kësaj ndërmarrje, Ardian Sylja, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se minatorët janë

jashtë rrezikut për të humbur jetën.

Lidhur me këtë ngjarje ka reaguar edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, i cili ka bërë me dije se me shqetësim ka ndjekur situatën në ndërmarrjen "Trepça", ku një trafo 110 kw ishte djegur tërësisht. Si pasojë e saj është ndërprerë energjia elektrike për minierën kryesore të Stan Tërgut, duke lënë pa energji elektrike edhe disa fshatra. "Ekipet e shpëtimit janë në vendngjarje dhe po punojnë që t'i shpëtojnë minatorët. Miniera ka ajrosje natyrale prandaj, sipas personave përgjegjës në terren, nuk paraqet rrezik serioz mungesa e ajrosjes. Lutem që të gjithë minatorët të jenë mirë me shëndet dhe së shpejti t'u bashkohen familjeve", ka thënë ministri Lluka.

Djegjen e trafosë brenda objektit të "Trepçës" e kanë konfirmuar

edhe zyrtarë të Distribucionit për Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), të cilët kanë treguar se kjo djegie ka shkaktuar ndërprerjen e energjisë elektrike në Mitrovicë. Në një komunikatë për media thuhet se KEDS-i ka dërguar menjëherë ekipet në vendin e ngjarjes, për ku është nisur edhe menaxhmenti nga Prishtina për t'u dalë në ndihmë këtyre ndërmarrjeve që të tejkalohet sa më shpejt kjo situatë.

KEDS-i ka arritur ta rikthejë energjinë elektrike për rreth 2/3 e konsumatorëve të Mitrovicës, duke e kaluar furnizimin nga linjat që vijnë nga Vushtrria, ndërsa nuk ka alternativë për konsumatorët që furnizohen nga "Trepça" dhe linja e KOSTT-it në Shupkoc, përkatësisht një pjesë e Mitrovicës dhe fshatrat afër, nga Mitrovica në drejtim të Vushtrisë.

MMPH-ja dhe GIZ-i, projekt për kthimin e shisheve të plastikës, qelqit dhe kënaçeve

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me sekretarin Arben Çitaku dhe këshilltarët politikë janë takuar të martën me sekretaren e parë të Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë, Anja Becky, udhëheqësen e projektit Alexandra Linden dhe përfaqësues të tjerë të GIZ-it gjerman. Gjatë këtij takimi është prezantuar projekti i krijimit të sistemit të kthimit të depozitave, i cili do realizohet nga MMPH-ja me përkrahjen e GIZ-it gjerman. Me këtë rast, ministri Matoshi ka ofruar mbështetjen për realizimin e këtij projekti i cili do të ndikojë në krijimin e një mjedisi

të pastër.

Matoshi ka thënë se në këtë projekt do të përfshihet kthimi i shisheve të plastikës, qelqit dhe kënaçet. "Shisheet e plastikës, qelqit dhe kënaçet së shpejti do të përfshihen në një sistem të kthimit të tyre, në mënyrë që të mbrohet mjedisi dhe të kemi riciklim të mbeturinave në vend", ka deklaruar Matoshi. Ai ka thënë se ndotja e mjedisit nga plastika është një ndër problemet që ka Kosova në fushën e mjedisit. Ndërsa përfaqësuesit e Ambasadës së Gjermanisë dhe GIZ-it kanë ofruar mbështetje për MMPH-në për realizimin e projekteve që janë paraparë për mjedisin.



Protestuan punëtorët teknikë të shkollave në Prishtinë

PRISHTINË, 22 JANAR - Punëtorët teknikë të disa shkollave të Prishtinës kanë protestuar të martën para Komunës së Prishtinës lidhur me mosrritjen e pagave si dhe moskthimin nën menaxhim të komunës sipas Ligjit për kryeqytetin. Punëtorët po kërkojnë që të kthehen si

pjesë e sektorit publik dhe t'u paguhen pagat më 4 për qind rritje nga 1 janari 2018. Sipas tyre, ka neglizhencë nga ana e Komunës së Prishtinës për kthimin e këtyre punëtorëve nën menaxhimin e komunës, sipas Ligjit për kryeqytetin, i cili është aprovuar vitin e kaluar. (Rel)



Më 25 janar do të bëhet inspektimi i Kompleksit Memorial 'Adem Jashari' në Prekaz

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Të martën është mbajtur takimi konstituiv i Komitetit Ndërmëtor për përzgjedhjen e projektit të Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, i themeluar më 15 janar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 02/84. Komiteti që kryesohet nga Gazmend Sylja, këshilltar politik i

kryeministrit, ka në përbërjen e vet anëtarë nga disa ministri, nga Muzeu, nga Instituti i Historisë dhe nga ai Albanologjik si dhe nga përfaqësuesit e Komunës së Skenderajt, familjes Jashari dhe Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

Në këtë mbledhje bashkëpunuesit janë marrë

vesh rreth metodës dhe dinamikës së punës si dhe është konfirmuar vullneti i Qeverisë që ky projekt të përmbyllet sa më parë. Takimi i radhës është caktuar më 25 janar dhe do të mbahet në Prekaz, në orën 14:00, ku do të bëhet edhe inspektimi i vendit të ngjarjes dhe do të shihet pamja e qartë e kompleksit.

'Heronjtë e Dukagjinit' bëhet me pajisje të reja të teknologjisë informative

DEÇAN, 22 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, bashkë me drejtorin e Arsimit, Bekim Vishaj, dhe bashkëpunëtorët të tjerë, kanë pritur në takim përfaqësues të organizatës gjermane "Humanity First", konkretisht presidentit të kësaj organizate, Abdullah Uwe Hanse Peter Wagishauser me bashkëpunëtorë. Gjatë këtij takimi kryetari Ramosaj i ka njoftuar ata me specifikat e Komunës së Deçanit, zhvillimet në këtë komunë, ecurinë për realizim të projekteve, planet për të ardhmen, konkretisht në sektorin e arsimit, duke marrë parasysh se kjo organizatë do t'i ndihmojë shkollat.

Duke i falënderuar për vizitën, njëkohësisht edhe për donacionin që i dhuruan ShFMU

"Heronjtë e Dukagjinit" në Gllgjan, ku kanë pajisur kabinetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Ramosaj ka thënë se ky bashkëpunim i nisur mbarë përmes DKA-së uron të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Përfaqësues të organizatës gjermane "Humanity First" kanë vizituar ShFMU "Heronjtë e Dukagjinit", të cilët janë pritur nga drejtoresha e kësaj shkolle, Lumnie Avdijaj, personeli i shkollës dhe nxënësit, me ç'rast është pranimi i këtij donacioni. Drejtoresha e kësaj shkolle dhe nxënësit janë shumë të kënaqur që tashmë në shkollën e tyre kanë një kabinet të TIK-ut të kompletuar ku, pos teorisë nga mësimdhënësit, do të mësojnë edhe në praktikë.



Nën patronazhin e kryetarit, z. Agim Bahtiri

Komuna e Mitrovicës

Q.S.H.M

dhe

organizojnë

AKADEMI PËRKUJTIMORE

me rastin e 103 vjetorit të rënies së Heroit Kombëtar, ISA BOLETINI

Mitrovicë
23 janar 2019

Nesër në Mitrovicë mbahet akademi përkujtimore për Isa Boletinin

Mitrovicë, 22 janar (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, nesër (e mërkurë) në orën 12:00 do të mbahet

Akademi Përkujtimore me rastin e 103-vjetorit të rënies së heroit kombëtar Isa Boletini. Akademia mbahet në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica" në Mitrovicë.

Vazhdon greva në arsim

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) u ka bërë apel kryetarëve të komunave, edhe drejtorive arsimore, që mos të bëjnë presion për thyerje të grevës në komunat e tyre si dhe mos të përfshihen në 'konflikt' derisa ata s'kanë mundësi të zgjedhjes së kërkesave të shtruar nga SBASHK-u

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 22 JANAR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije të martën se, pavarësisht prej presioneve, greva është duke vazhduar në të

gjitha komunat, me përjashtim të shkollës "Heronjtë e Dukagjinit" në Glogjan të Deçanit. "Pavarësisht prej presioneve të mëdha në disa komuna, e sidomos presionit të madh që është duke u bërë në Komunën e Deçanit, edhe dita e shtatë e grevës së punonjësve arsimor është mbajtur në të

gjitha komunat, në përjashtim të shkollës 'Heronjtë e Dukagjinit' në Glogjan, e cila numëron 15 anëtarë, edhe në shkollën 'Dëshmorët e Vokshit' në fshatin Pobërgj një mësimdhënëse ka tentuar të mbajë orën e parë, por edhe ajo iu ka bashkëpunuar grevës në Komunën e Deçanit", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

Të martën kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, me bashkëpunëtorë ka vizituar grevistët në Komunën e Pejës si dhe Këshillin Grevist në Deçan për të biseduar për gjendjen në këtë komunë. "Vizita grevistëve

iu bënë edhe në Prishtinë nga anëtarë të tjerë të Këshillit Qendror Grevist në çerdhen 'Xixëllonjat' në Prishtinë, ku biseduan për ofertën e ofruar nga Qeveria si dhe për vendimin që ka marrë Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në takimin e djeshëm", është theksuar më tutje në komunikatë. SBASHK-u u ka bërë apel kryetarëve të komunave, edhe drejtorive arsimore, që mos të bëjnë presion për thyerje të grevës në komunat e tyre si dhe mos të përfshihen në 'konflikt' derisa ata s'kanë mundësi të zgjedhjes së kërkesave të shtruar nga SBASHK-u, kërkesa të

cilat vlejnë për tërë territorin e Republikës së Kosovës. "Njëherësh, kërkojmë nga ata që para se ta ftojnë Këshillin Grevist në biseda 'informative' t'i lexojnë ligjet mbi organizimin sindikal, Ligjin e grevës dhe statutin e SBASHK-ut dhe nga ato mund të marrin informata të sakta, se greva është e shpallur në nivel vendi dhe këtë të drejtë të shpalljes së grevës e ka pasur Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, i cili është i vetmi organ legjitim që mund ta përfundojë grevën në rast se janë plotësuar kërkesat", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.



Guvernatori Mehmeti kërkon nga FKPK-ja rritje të kujdesit të menaxhimit të kontributeve pensionale

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka takuar anëtarët e Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), të kryesuar nga Ruzhdi Morina. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka kërkuar sqarime më të hollësishme rreth zhvillimeve të fundit lidhur me performancën financiare të investimeve të FKPK-së, e cila, pavarësisht prej performancës pozitive gjatë pjesës më të madhe të vitit 2018, në tremujorin e fundit të vitit 2018 shënoi rënie si rezultat i zhvillimeve në tregjet globale financiare. Guvernatori Mehmeti vlerësoi pozitivisht performancën e investimit të

kontributeve pensionale në dhjetë vjetët e fundit, e cila, sipas raporteve të FKPK-së, ka siguruar një kthim pozitiv në investime në vlerë prej 380.09 milionë eurosh.

Guvernatori kërkoi nga përfaqësuesit e FKPK-së që ta shtojnë kujdesin në menaxhimin e luhatjeve afatshkurtra të tregjeve globale, të ngjashme me ato të periudhës së fundit, në mënyrë që të minimizohen rreziqet për investimet e kontributeve pensionale të qytetarëve të Kosovës.

Për më tepër, guvernatori Mehmeti kërkoi rritje të komunikimit të FKPK-së me publikun në mënyrë që qytetarët të jenë mirë të informuar dhe të kenë kuptim të drejtë të zhvillimeve



në tregjet financiare globale e të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në vlerën e kursimeve të tyre pensionale. Ndërsa kryesuesi i Bordit

Drejtuës të FKPK-së, Ruzhdi Morina, njoftoi guvernatorin rreth zhvillimeve të lidhura me investimet e FKPK-së në tregjet financiare ndërkombëtare, duke

theksuar se rënia e shënuar në tremujorin e fundit të vitit 2018 deri në një masë është kompensuar me kthimin pozitiv që kanë shënuar investimet e FKPK-së gjatë muajit janar 2019.

Ai theksoi se investimet e FKPK-së bazohen në një politikë mjaft të kujdesshme të investimit, të bazuar në një baraspeshë mjaft konservative ndërmjet kthimit dhe rrezikut, e cila në periudhën afatgjatë ka rezultuar me një performancë mjaft të kënaqshme të investimeve. Në këtë kontekst, me gjithë luhatjet afatshkurtra të tregjeve globale, kryesuesi i Bordit Drejtues të FKPK-së theksoi se perspektiva afatgjatë e investimeve të kontributeve pensionale të qytetarëve të Kosovës është pozitive.

14 persona të lënduar në aksidente trafiku kërkuar ndihmë në Emergjencë

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, sipas raportit të punës, gjatë 24 orëve, 206 persona kanë kërkuar

ndihmë mjekësore. Prej tyre, 43 janë trajtuar në dhomën e reanimimit, derisa janë regjistruar 34 raste kirurgjike, 100 raste internistike dhe 25 raste ortope-

dike. Në Emergjencë morën tretmanin mjekësor edhe 14 persona të cilët kanë pësuar lëndime në aksidente trafiku. Nga numri i

përgjithshëm, që kanë kërkuar ndihmë në Emergjencë, 26 pacientë janë pranuar në reparte të ndryshme të QKUK-së për ta vazhduar trajtimin.



Gjermania dhe Franca nënshkruajnë traktat të ri bashkëpunimi



Kancelarja gjermane Merkel dhe presidenti francez Macron nënshkruan një traktat për rigjallërimin e miqësisë shumëvjeçare mes vendeve të tyre, pikërisht 56 vjet pas Traktatit Elysee të vitit 1963, që përcaktoi marrëdhëniet e afërta që do të kishin të dy vendet pas shekujsh me konflikte, të cilat morën fund me Luftën e Dytë Botërore

BERLIN, 22 JANAR - Kancelarja gjermane Angela Merkel paralajmëroi të martën për rrezikun e rritjes së nacionalizmit në Evropë dhe bëri thirrje për rigjallërimin e bashkëpunimit ndërkufitar, pasi ajo dhe homologu i saj francez nënshkruan një traktat për rigjallërimin e miqësisë shumëvjeçare mes vendeve të tyre. Marrëveshja e re u nënshkrua në qytetin e lashtë të Gjermanisë Perëndimore Aachen, pikërisht 56 vjet pas Traktatit Elysee të vitit 1963, që përcaktoi marrëdhëniet e afërta që do të kishin të dy vendet pas shekujsh me konflikte, të cilat morën fund me Luftën e Dytë Botërore. "Në të gjitha vendet tona është duke u fuqizuar populizmi dhe nacionalizmi", u tha

Merkel zyrtarëve francezë, gjermanë dhe evropianë që ishin mbledhur në qendrën e qytetit Aachen. Ajo tha se bashkëpunimi ndërkombëtar po kalon nëpër një rrugë të vështirë dhe përmendi si shembull largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian si dhe rritjen e prirjeve proteksioniste në mbarë botën. Traktati i Aachenit synon fuqizimin e bashkëpunimit ndërkufitar mes të dy vendeve si dhe përmirësimin e koordinimit mes tyre për çështje ndërkombëtare, si ndryshimet klimatike dhe terrorizmi.

Gjermanisë dhe Francës shpesh i referohen si lokomotiva të Bashkimit Evropian, që ka shkaktuar pakënaqësi te vendet e tjera anëtare, të cilat ndihen të anashkaluara nga marrëdhënia

e afërt në mes të Parisit dhe Berlinit.

Sfondi historik i traktatit Aachen

Një ditë dimri më shumë se gjysmë shekulli më parë, Franca dhe Gjermania Perëndimore nënshkruan një traktat që synonte për të lënë pas shekujt e konflikteve që përfshinë dy luftëra botërore shkatërrimtare. Në kushtet e Luftës së Ftohtë, uniteti evropian ishte i kufizuar në një treg të përbashkët prej gjashtë anëtarësh, i cili fillimisht hodhi poshtë kërkesën e Britanisë për anëtarësim. Pak njerëz e parashikuan në atë kohë se ky traktat i janarit 1963 do të ndihmonte në çimentimin e një bashkëpunimi franko-gjerman për të realizuar atë që përfundimisht u bë Bashkimi Evropian me 28-anëtarë. Pikërisht 56 vjet më vonë, më 22 janar 2019, presidenti francez Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane Angela Merkel nënshkruan një pakt të ri, i cili përballet me sfida të reja. Të dy udhëheqësit janë dobësuar në vendet e tyre dhe BE-ja po

lufton me çështjen Brexit, nacionalizmin në rritje dhe ndarjet mbi çështjet thelbësore si migracioni, ekonomia dhe mbrojtja.

Disa analistë thonë se traktatit të ri të Aachenit i mungon substancia, ndërsa nacionalistët francezë të ekstremit të djathtë kanë hedhur paralajmërime të rreme duke pretenduar se Parisi planifikon të lëshojë pjesë të territorit të vendit dhe të ndajë me Berlinin pozitën si vend anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit. Pakti ngre një pyetje më të gjerë: Sa rëndësi ka bashkëpunimi franko-gjerman në Evropën e sotme të rrethuar nga vështirësitë? "Dikur thuhej se kur Franca dhe Gjermania binin dakord për diçka, kjo pak a shumë kthehej në një vendim për BE-në. Tani kjo nuk mjafton", thotë Manuel Lafont Rapnouil, kreu i Zyrës së Parisit i Këshillit Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë.

Marrëveshja e re synon ta thellojë bashkëpunimin franko-gjerman në fushën e arsimit, mjedisit, sigurisë dhe politikës ekonomike, ndër të tjera. Qyteti gjerman Aachen, i njohur në frëngjisht si Aix-la-Chapelle,

është shumë simbolik - dikur ka qenë kryeqytet i perandorit frank Karli i Madh. Një vit para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u bë qyteti i parë gjerman i kapur nga aleatët pas një beteje shkatërrimtare. Por, kritikët thonë se traktati i ri mbetet shumë larg ambicieve për një Evropë më të fuqishme dhe të unifikuar, që presidenti Macron theksoi në një fjalim të vitit 2017, pak muaj pas marrjes së detyrës. "Një pakt i ri, por pak ambicie", shkruante gazeta franceze Le Monde, në prag të nënshkrimit. "Është një bazë mbi të cilën mund të punojmë, por që reflekton kufizimet e dy qeverive", thotë Joachim Bitterlich, ish-këshilltar i ish-kancelarit gjerman Helmut Kohl, për gazetën Le Journal du Dimanche të Francës, në të cilën ai përmend mangësitë në fusha si migrimi dhe bashkëpunimi energjetik.

Gazetari rus Leonid Bershidski përshkruan disa çështje që ai beson se pengojnë marrëveshjen, siç janë interesat e ndryshme gjermano-franceze në fusha si mbrojtja dhe bashkëpunimi ekonomik. "Shprehjet simbolike të solidaritetit janë të rëndësishme në këto kohë përçarjesh. Por në jetën reale, për të punuar së bashku është e vështirë, madje edhe për partnerët me qëllimet më të mira", shkruante ai në një artikull për gazetën Bloomberg.

Presidenti Macron dhe kancelarja Merkel takohen në një pikë të ulët popullariteti në mandatin e tyre si udhëheqës. Kancelarja gjermane po shqyrton largimin nga posti, pasi tashmë ia ka dhënë kontrollin e partisë së saj të Bashkimit Kristian Demokratik një aleateje, Annegret Kramp-Karrenbauer. Presidenti Macron ka parë rënien e popullaritetit të tij në nivel rekord mes protestave të vazhdueshme kundër reformave të tij dhe rritjes së kostos së jetesës.

Ndërsa Bashkimi Evropian ka shfaqur unitet në negociatat me Britaninë rreth çështjes Brexit, blloku është i ndarë në shumë aspekte të tjera, edhe pse partitë nacionaliste priten ta rrisin fuqinë e tyre në rritje në zgjedhjet e Parlamentit Evropian këtë maj.

Rusia dhe Japonia nuk arrijnë pajtim për mosmarrëveshjet territoriale

MOSKË, 22 JANAR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka thënë se ka ende punë përpara se Rusia të arrijë një traktat paqesje me Japoninë për t'i dhënë fund zyrtarisht Luftës së Dytë Botërore. Putini foli në Moskë më 22 janar, pas bisedimeve me kryeministrin japonez Shinzo Abe, i cili tha se

ai dhe presidenti rus kishin konfirmuar vendosmërinë e tyre për të gjetur një zgjidhje për një mosmarrëveshje territoriale disadkadëshe. Abe tha se ministrat e jashtëm të të dyja vendeve kanë vendosur të takohen në shkurt për të biseduar rreth mosmarrëveshjes mbi katër ishujt jugorë të Kuriles.

Trupat sovjetike pushtuan ishujt gjatë ditëve të fundit të Luftës së Dytë Botërore. Refuzimi i Tokios për ta njohur sovranitetin e Moskës ka ngadalësuar procesin e paqes që nga vitet 1950. Shtatë dekada më vonë ishujt njihen si Kurile Jugore në Rusi dhe si Territorët e Veriut në Japoni.



PAL NDRECAJ

POEZIA

Gjithçka ish zhytur në një pauzë të thellë të rëndë mbytëse

Pauzonin njerëzit bimët
ajri uji
akrepa busulla

Pauzonin ngjyrat ndjesitë
foljet që u jepnin kuptime

Sendë emra ngjarje
koha pauzonte

Derisa një zog shpërthen përmes plasaritjes së
lëvozhgës së një emocioni
që s'përmbahet ma
dhe del e merr dynjanë

Pastaj krejt nisin me lëviz përsëri...

EKLIPSI

Eklipsi më i tmerrshëm është ai
mes teje e ëndrrës
kur hyn ndërmjet mungesa e vetëbesimit

Atëherë ti nuk di deri ku rrjedhin
ujërat tua
a e kanë hapur një vijë që duhet me qenë vija e
tyre
për me i bartë ato ndo'j lugine me bar
ndo'j kodre me pisha
në mënyrë që nesër kur duhet të kenë mbërritur te
derdhja
me mujte me thanë: po, isha!

KJO ERË E FORTË

Ora ka vajtur vonë dhe unë nuk kam gjumë
një erë e fortë përplas degët e kujtimeve

ajo barka që mëdyshej mes valëve në lumë
s'la gjurmë në ujë po në fytyrën time

Lart në kodër një zjarr i madh
ndez krandet e tërë botës
mbledhur pak nga pak aty

O mos e shpjerni këtë dushk
që u shkund sonte mos
se do të mbulohej bota në tym të zi

VARGJE QË NGELËN
PA TITULL

... këtu u ndërpre krijimi puna u kaloi sofistëve
gdhendën çka gdhendën shpirtin ua lanë artistëve
këta e morën punën siç dinë - përnjëmend

E keni parë një pëllumb të bardhë të bukur
që mbi supet tuaja kërkon një vend

Pastaj ndërhyjnë politikanët si lakejt
se ç'i përzien sendet se ç'i çmendën krejt

Rrejtën politikanët se botën do ta bëjnë të bukur
mbasi ta gatuajnë si u duket mbarë
po në atë gatim shumë helm qe futur
kush dje e shijoi sot e ndien zarar

Vunë rregullat e lojës për pushtetin:
mashttrimin për mashttrim e "hajt kjoqshim
shnosh..."
në bankat ku deponuan falsitetin
ne fusim kartelën dhe na del bosh

Nga "Gdhendja e përmasave"

TEUTA

Sipas romanit "Teuta" të Mirash Martinoviqit

Në Rizon Roma të fton në bisedime
për piratët nisin por pushtimin lanë ta kuptosh
ti vesh fustan prej lulesh që me bukurinë tënde
mllefën Perandorisë t'ia frenosh

Po mllefën s'e përmbajti dot asnjë armik
para bukurisë tunduese
e shkrijnë atë në uzina e bëjnë çelik
për shigjetat helmuese

Në Rizon në detin e hapët bisedimet dështojnë
dhe niset flota romake me heshta e curle.
Mbretëreshë ti s'bane vetëvrasje legjendat kallë-
zojnë
ti u fshehe mes bimësh u shndërrove në lule

Kështu thonë Teutë të gjitha legjendat
që iu mbështollën Ilirisë si gërsheti yt
centorioni kot priste me shpatë në dorë
a prehet legjenda në fyt

Artisti Bardhyl skaliste zotat ilirë
në gurë gjigantë nën hije
i ke pa Mbretëreshë ti ma mirë se unë
si i barten pastaj ilirët në vetëdije

Sa herë ilirët provonin pas humbjes
të ngrenë prapë atë që u kish dhënë emër
Medauri prej gurit e ti prej lulesh
dilnit e u jepnit zemër

Legjendat për ca bimë flasin gjithnjë
që fytyrën e një mbretëreshë të sillnin në mend
dhe mbinin nëpër Iliri një nga një
ta përhapnin imazhin tënd

Andej pra nga bimët shpërthente legjenda
për një grua që bredh mbretërisë anë e m'anë
t'ua ruajë dinjitetin brezave ilire
t'ua kujtojë kush janë

Në Rizon Zoti Medaur në gurin e Bardhylit ulet
sheh flotën romake tek zbarkon n'pikë t'natës
ti duhej të fshiheshe Teutë pikërisht te lulet
për t'i kundërvënë Romës flotën e imagjinatës

Që do të niste shpirttrave të Ilirise së pushtuar
udhëtimin nëpër shekujt që na e lypnin besën
Mbretëreshë Iliria ngeli tregim i pambaruar
rri aty mes lulesh na e ruaj kujtesën

Miratohet konceptdokumenti për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Pas propozimit të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në mbledhjen e së martës të Qeverisë së Kosovës, është miratuar Konceptdokumenti për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, me qëllim të krijimit dhe zhvillimit të politikave dhe mekanizmave të përshtatshëm për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë sikurse dhe avancimi i infrastrukturës ligjore me qëllim të krijimit të kushteve adekuate teknike dhe profesionale. Ministri Gashi ka pohuar se këto janë objektiva institucionale, njëherësh prioritetet afatmesme të parapara dhe në politikën si dhe dokumentet relevante strategjike të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Në kuadër të mbështetjes institucionale të sektorit të rinisë dhe vizionit programor 2019-2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht si një ndër katër shtyllat strategjike të këtij vizioni, miratimi i këtij konceptdokumenti dëshmon për rëndësinë,

njëherësh përkushtimin institucionale për mbështetjen dhe avancimin e sektorit të rinisë në vendin tonë", tha ministri Gashi. Ministri Gashi para kabinetit qeveritar ka sqaruar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë tek objektivi Promovimi dhe mbështetja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe te lista e Konceptdokumenteve për vitin 2019 ka parapare hartimin dhe aprovimin e Konceptdokumentit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë. "Konceptdokumenti paraqet një bazë të qëndrueshme për ta vazhduar përkrahjen e të rinjve në fushat e politikave sektoriale si dhe duke iu përshtatur nevojave dhe kërkesave të rinjve në të dy nivelet e pushteteve, në atë lokal dhe atë qendror. Nevoja e rishikimit të kornizës ligjore në fuqi bazohet në sfidat e identifikuar gjatë zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar si dhe rrethanave të reja të krijuara përgjatë kësaj periudhe



kohore siç janë: mosha, edukimi, punësimi i të rinjve të Kosovës, zhvillimi i njohurive rreth inovacioneve të prezantuara si nevojë e kohës së sotme, njohja e punës vullnetare,

çështja e stimulimit më të madh të të rinjve për krijimin dhe zbatimin e politikave në vendimmarrje, pjesëmarrja aktive e rinjve në punën vullnetare, shkëmbimi i përvojave në

punë të punëtorëve të rinj si dhe angazhimi i të rinjve në projektet rinore rajonale dhe ndërkom-bëtare", ka arsyetuar ministri Gashi, duke kërkuar edhe aprovimin e konceptdokumentit në fjalë.

E rrallë

Në Turqi një votuese është 165 vjeçe

Çudia në Turqi, një votuese është 165 vjeçe! Partitë politike në Turqi po bëjnë të pamundurën që t'i bindin njerëzit për t'ua dhënë votën. Por, në listën zgjedhore janë vënë re disa çudira. Aty u renditën disa votues mbi 100 vjeç, ku moshja e një gruaje ishte 165-vjeçare. Zbulimi u bë përpara zgjedhjeve lokale që do të mbahen në mars, në të cilën Partia AK e presidentit Erdogan mund të përballlet me sfidën më të vështirë politike në vite.



FOTO E DITES



Kjo fotografi tregon ndërtesat tregtare dhe rezidenciale në Hong Kong. Fotoja është publikuar nga "Zëri i Amerikës".

E jashtëzakonshme

Bukë me insekte të bluara

Në shoqërinë shqiptare insektet luftohen, por në shoqëri të tjera përdoren si ushqim. Risia më e fundit është një bukë e gatuar nga mielli i insekteve të bluara. Ideja është realizuar nga një kompani finlandeze "Fazer Bakery", e cila ka një reputacion për të bërë bukë duke përdorur miell. Fazer filloi përdorimin e insekteve në bukën e tyre, pasi Finlanda hoqi ndalimin e



shitjes së insekteve që do të përdoren për ushqim kohët e fundit.

BARSOLETA E DITËS



Derisa po patrullonin dy policë, njëri i thotë tjetrit:
- A po shkon në furrë ta blesh një byrek, se kam uri?
Ky tjetri shkon në furrë e, kur kthehet, i thotë:
- Nëse e di sa byrekë kam blerë do të t'i jap që të dy.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Në ditën e sotme do të mbusheni nga entuziazmi dhe gjallëria. Do ta gjeni mënyrën për ta dëgjuar arsyen e jo zemrën. Duhet të bëni një përpjekje të dyfishtë për t'i dëgjuar të gjitha anët e historisë.



DEMI

Në ditën e sotme do të mund të përqendroheni vetëm në një aspekt të situatës që po kaloni. Do të sfidoheni të inspektoni pikëpamje të ndryshme të realitetit që nuk pëlqeni.



BINJAKËT

Në ditën e sotme po kërkoni avantazhe. Mund të dilni shumë shpejt nga udha e një projekti të rëndësishëm e të vështirë duke pranuar një detyrë më të lehtë e më pak të rëndësishme.



GAFORRJA

Elementet e nevojshme të vullnetit do të mungojnë në ditën e sotme. Duhet t'i vini vetes qëllime në mënyrë që ta keni më të lehtë të bëni përpara.



LUANI

Ndoshta do të përballeni me një konkurrencë të fortë, por do të keni edhe shumë mbështetje. Ana sociale e jetesës është shumë e fortë në mënyrë të ndryshme.



VIRGJËRESHA

Në ditën e sotme do të prireni ta ndërtoni imagjinatën e besimit mbi faktet dhe logjikën. Kjo do t'ju ngjallë dëshirën të rreme, premtim dhe konkluzione. Mendoni vetëm gjëra reale, pra ato që shihni kudo ku shkon dhe mos fantazoni shumë.



PESHORJA

Në ditën e sotme do ta keni aftësinë për të filluar projekte të reja dhe për t'i motivuar njerëzit. Do të keni një dëshirë të madhe për të lëvizur përpara, megjithatë tregoni kujdes. Mos krijoni shpresa të gabuara për të ardhmen.



AKREPI

Në ditën e sotme do të tërhiqeni nga njerëzit që kanë ëndrra të mëdha por, ndoshta, do të keni pak aftësi për t'i realizuar. Tregoni kujdes për metodat që po përdorni. Rrezikoni të zhgënjeheni shumë shpejt.



SHIGJETARI

Ju po kërkoni suksesin tuaj, por keni pak durim për ata që nuk po ju mbështesin. Ju po kërkoni njerëzit që kanë të njëjtën mendje si ju, por është e vështirë të gjenden. Megjithatë, yjet ju këshillojnë t'i sfidoni pengesat që do t'ju dalin.



BRICJAPI

Tregoni kujdes se mos kërkoni zgjidhjet në vendet e gabuara dhe te njerëzit e gabuar. Dëgjoni edhe ata që ju kundërshtojnë dhe jo vetëm ata që përgjigjen gjithmonë me "po".



UJORI

Në ditën e sotme do të jeni në gjendje t'i bëni të tjerët t'ju dëgjojnë. Do t'ia dilni të gjeni zgjidhje dhe të prisni miratime edhe atje ku shpresat janë vërtet të pakta.



PESHQIT

Dikush po ju pengon, prandaj ju duhet t'i parashikoni mundësitë për t'i kaluar pengesat në mënyrë që t'ia dilni me sukses. Projekti juaj i fundit do t'ju japë shumë përgjegjësi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

HEARTS - DUNDEE

1

SEVILLA - BARCELONA

2

NIMES - ANGERS

1

Të premtën vendoset e ardhmja e Fetahajt

Liridon Fetahaj të premtën do të takohet me drejtuesit e Klubit të Prishtinës për të mësuar të ardhmen e tij. "Ende nuk e di se ku do të luaj në pjesën tjetër të kampionatit, por të premtën kam takim me drejtuesit e Prishtinës dhe aty vendoset një gjë e tillë. Momentalisht jam duke u përgatitur në mënyrë individuale që për pranverë të jam në formë të mirë fizike", ka thënë Fetahaj

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 JANAR - Futbollisti Liridon Fetahaj ishte i huazuar te skuadra e Lirisë së Prizrenit në sezonin vjeshtor nga Prishtina, por ai ende nuk e di se cilën fanellë do të djersijë në sezonin pranveror. I kontaktuar të martën nga gazeta "Epoka e re", Fetahaj ka thënë se gjithçka rreth së ardhmes së tij do të sqarohet të premtën. Ai ka mohuar ta tregojë dëshirën se për cilën skuadër do të paraqitet në pranverë. "Ende nuk e di se ku do të luaj në pjesën tjetër të kampionatit, por të premtën kam

takim me drejtuesit e Prishtinës dhe aty vendoset një gjë e tillë. Momentalisht jam duke u përgatitur në mënyrë individuale që për pranverë të jam në formë të mirë fizike", ka thënë Fetahaj, i cili para fillimit të kampionatit 2018/2019 u huazua nga Prishtina te ish-skuadra e tij, Liria, për shkak se nuk kishte hapësirë në mjaftueshmëri në skuadrën kryeqytetase. Këtë huazim në skuadrën prizrenase sulmuesi anësor e shfrytëzoi për mrekulli për faktin se u shndërrua ndër lojtarët më të mirë në skuadrën e Lirisë. Kontrata e Fetahajt me skuadrën e Prishtinës është e vlefshme

deri në qershor të vitit 2020. Fetahaj në skuadrën e Lirisë ka pasur rastin që gjatë sezonit vjeshtor të punojë me trajnerin italian Vincenzo Alberto Annese. "Po, ka një metodë interesante të punës. Kërkon shumë përkushtim si në stërvitje, po ashtu edhe në lojë, pra është një përvojë e mirë për mua si futbollist që kam pasur rastin të punoj me këtë trajner", ka shtuar Fetahaj. Skuadra e Lirisë e mbylli sezonin vjeshtor në pozitën e dhjetë me 19 pikë të grumbulluara derisa regjistroi gjashtë fitore, një barazim dhe dhjetë humbje në shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara.

SHKURT

Këndellet KF Ferizaj

KF Ferizaj është këndellur pas problemeve që e përcollën klubin sezonin e kaluar. Bordi udhëheqës i klubit ka emëruar kryetar Mustafa Graincan, i cili e zëvendëson në këtë pozitë Sadush Ryshan. Pas zgjedhjes së kryetarit të ri, Mustafa Grainca, klubi e ka rikthyer edhe trajnerin Bylbyl Sokoli. "Profa" do ta zëvendësojë të larguarin Afrim Tovërlani, kurse synim i kësaj skuadre është mbetja në Superligë.

Karrica zyrtarisht lojtar i Dinamo Zagrebit

Futbollisti Bernard Karrica edhe zyrtarisht është pjesë e skuadrës kroate Dinamo Zagreb. KF Gjakova ka njoftuar se futbollisti i tyre është transferuar në futbollin kroat. "Futbollisti yni dhe i Kombëtares kuqezi (U19), Bernard Karrica, është anëtar i klubit të madh kroat Dinamo nga Zagrebi. Ne si kryesi e klubit i urojmë suksese dhe besojmë se shumë shpejt Karrica do t'i prekë majat e futbollit evropian", thuhet në njoftimin e KF Gjakova.

Pronari i kompanisë "Besa Security" ndihmon KHF Istogu

Pronari i kompanisë "Besa Security", Abedin Hasani që është vëllai i presidentit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani ka ndarë një donacion prej 500 euro për KHF Istogun. "Këto mjete janë të dedikuara për pagesën e operacioneve të tri hendbollistëve tona të lënduara, që KHF Istogu i ka operuar në vlerë prej 8500 euro. Është kjo ndihma e parë e një kompanie në shërim të hendbollistëve apo në ndihmën e pagesave të trajtimit të hendbollistëve të lënduara. Duke marrë parasysh që KHF Istogu në këtë fillim viti ka vështirësi të mëdha financiare pasi që nevojitet organizimi i ndeshjeve ndërkombëtare me ekipin spanjoll Malaga dhe poashtu shpenzimet e larta duke marrë parasysh që kemi operuar tri hendbolliste në shumën e lartcekur", thuhet në njoftimin e skuadrës së Istogu.

Prishtina e pret S. Oliver Wurzburgun

PRISHTINË, 22 JANAR - Z Mobile Prishtina sot (e mërkurë) do të përballet me ekipin s. Oliver Wurzburg të Gjermanisë në kuadër të Grupit I të FIBA Europe Cup. Ndeshja do të luhet me fillim nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

Z Mobile Prishtina në tri xhirot e para të këtij grupi ka realizuar dy humbje dhe një fitore. Disfatat i ka pësuar nga Pinar Karsiyaka në Turqi dhe s. Oliver Wurzburg në Gjermani, kurse fitoren e vetme e ka shënuar në Prishtinë në balafaqim me skuadrën hungareze

Szolnoki Olaj. Lider i Grupit I është s. Oliver Wurzburg me 6 pikë, kurse pozitën e dytë e mban Pinar Karsiyaka me 5 pikë, ndërsa në pozitën e tretë është Z Mobile Prishtina me 4 pikë dhe në të katërtën Szolnoki Olaj me 3 pikë. Pas duelit me s. Oliver

Wurzburg, Z Mobile Prishtina do të përballet edhe me Szolnoki Olaj si mysafir në Hungari më 30 janar dhe më 6 shkurt si nikoqire me Pinar Karsiyaka. Duhet theksuar se dy ekipet e para të grupit do të avancojnë në 1/8 e finales së FIBA Europe Cup, kurse dy të



tjerat do t'i japin fund aventurës evropiane.

Nadali në gjysmëfinale të "Australian Open"-it

MELBOURNE, 22 JANAR - Asnjë problem për Rafael Nadal në çerekfinale të "Australian Open"-it, turne të cilin e ka fituar vetëm një herë në karrierë 10 vjet më parë. Tenisti spanjoll theu me rezultatit e pastër 3-0 (6-3, 6-4, 6-2) në vetëm 1 orë e 49 minuta lojë amerikanin Frances Tiafoe. Asnjë

lojë e humbur nga Nadal me shërbimet e tij dhe mbi 10 % të pikëve të fituara direkt në shërbim. Spanjollit nuk shërbente kaq fort dhe me kaq shumë efikasitet që nga US Open 2010. Djaloshi amerikan Tiafoe duhet ta ketë kuptuar se nuk mund të shkonte përtej limiteve të tij, faza

çerekfinale mbetet gjithsesi një arritje për të. Në gjysmëfinale të Australian Open Nadal do t'i matë forcat me një tjetër të ri tepër të talentuar, grekun Stefanos Tsitsipas që, pasi nxori jashtë turneut Federer-in, eliminoi në këtë raund Bautista-Agut.



IJF: Majlinda e gatshme për 2019-n

PRISHTINË, 22 JANAR - Federata Ndërkombëtare e Xhudos, IJF, e ka publikuar një artikull me pesë gjërat më të rëndësishme që nuk duhet t'i humbisni në Grand Prixin e parë këtë vit, në Tel Aviv të Izraelit, që do të zhvillohet nga e enjtja, 24 janar, deri të shtunën, 26 janar. Sipas këtij artikulli të IJF, një ndër gjërat që nuk duhet t'i humbisni në këtë garë është ndeshja e parë e Majlinda Kelmendit për këtë vit, e cila synon ta fillojë rrugën drejt titullit të kampiones së botës, që do të tentojë ta marrë në Tokio 2020. Kampionia olimpikë në Rio 2016 dhe ish-kampionia e botës, Majlinda Kelmendi nga Kosova, u kthye në garën e turneut botëror të IJF në fund të vitit 2018, ku arriti ta fitojë një medalje të argjendtë në Abu Dhabi Grand Slam dhe një medalje të artë në Tashkent Grand Prix, shkruan IJF.




Kelmendi, 27-vjeçare, do të jetë shumë aktive gjatë vitit 2019 tani që është shëruar nga lëndimi i saj dhe është gjithmonë e më afër për ta mbrojtur titullin e kampiones në Tokio 2020. Heroina e Kosovës pritet që të ngjitet shpejt nga pozita aktuale e saj në renditjen e xhudistëve, aktualisht gjendet në pozitën e

14-t. Përmes fitoreve që i kërkon këtë vit, ajo do të tentojë ta fitojë titullin e kampiones përsëri, për herë të parë që nga viti 2014. Kosova është duke u treguar mjaft e kujdesshme dhe duke e kthyer Kelmendin ngadalë në turneun botëror të IJF, pasi që kampionia olimpikë ende nuk është regjistruar për asnjë garë tjetër. Kelmendi pritet që të garojë në Paris, në garën që i ndihmoi asaj të bëhej e famshme, pasi që e fitoi Grand

Slamin francez katër herë. Megjithatë, kjo gjë mund të mos ndodhë pasi që ajo pritet të marrë pjesë edhe në gara të tjera, si në Grand Slamin gjerman në shkurt dhe në Rusi në mars. Gara e ëndrrave për Kelmendin do të ishte një ndeshje kundër kampiones së botës, japonezes Abe Uta. Një ndeshje e tillë mund të zhvillohet në Gjermani, pasi që japonezja nuk është e përfshirë në skuadrën e vendit të saj për garat në Francë.

Lakersat pësojnë humbje nga Golden State

LOS ANGELES, 22 JANAR - Fitorja e 33-të sezonale për skuadrën kampione të Golden State, që mundi 130-111 Lakersin, duke u hakmarrë për humbjen e pësuar për Krishtlindje. Ndeshja e luajtur në Los Angeles u dominua nga miqtë, superiorë në fushë gjatë gjithë kohës, duke u shkëputur ndjeshëm në perioidën e tretë. Mungesa e disa titullarëve të dëmtuar ndikoi në paraqitjen e Lakersit, ku u dallua Zubaqi me 18 pikë. Për Golden State u dallua Thompsoni me 44 pikë, ndërsa Duranti e mbylli me 20 pikë. Philadelphia mposhti me lehtësi 121-93 Houstonin, përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në konferencat përkatëse. Ndonëse pritej një sfidë më e fortë, skuadra teksane luajti dobët edhe pse Hardeni realizoi 37 pikë, por që mbetën për statistikë. Për Philadelphia u dallua Embiid me 32 pikë e 14 rebounde. Fiton edhe skuadra e Bostonit që, falë 26 pikëve e 10 asistimeve të Kyrie Irving, mposhti 107-99 Miamin, ndërsa



New Orleans triumfoi 105-85 në fushën e Memphisit (Hiliday e Mirotiq nga 21 pikë secili). Milwaukee vijon të dominojë në renditjen në Konferencën e Lindjes, duke fituar edhe sot 116-106 ndaj Dallasit, sfidë ku vendësit u shkëputën në perioidën e fundit. Antetokounmpo me 31 pikë e 15 rebounde ishte shënuesi më i mirë i ndeshjes. Nuk zhgënjën Oklahoma, që triumfoi 127-109 në fushën e New York, sfidë ku u dallua Paul George, autor i 31 pikëve. Në minutat e fundit triumfon

Portlandi, që mundi 109-104 Utah Jazzin (Lillard 26 pikë), ndërsa Chicago mposhti 104-88 Cleveland (LaVine 25 pikë).

REZULTATET

New York - Oklahoma	109-127
Cleveland - Chicago	88-104
Milwaukee - Dallas	116-106
Washington - Detroit	101-87
Atlanta - Orlando	103-122
Brooklyn - Sacramento	123-94
Memphis - New Orleans	85-105
Boston - Miami	107-99
Philadelphia - Houston	121-93
Utah Jazz - Portland	104-109
Lakers - Golden State	111-130

SHKURT

Vlera e Shaqirit është 40 milionë

Observatori i Futbollit (CIES) i ka publikuar të dhënat e fundit në lidhje me vlerat e disa lojtarëve, ku vlerësohet edhe transferimi i Xherdan Shaqirit. Ajo që është vlerësuar janë blerjet e verës si Cristiano Ronaldo, Alisson Becker dhe Xherdan Shaqiri. Futbollisti me orgjinë shqiptare, që luan aktualisht për Liverpoolin ka befasuar me paraqitjet dhe rritjen e vlerës së kartonit. Xherdan Shaqiri u transferua në verë te Liverpooli për 14.7 milionë euro, ndërsa tani ajo është ngritur për 40.3 milionë euro. Aktualisht vlera e kartonit të futbollistit vlerësohet 55 milionë euro. Ky është një rekord për një futbollist shqiptar.

Dënohet Ronaldo

Cristiano Ronaldo u thirr në seancën gjyqësore të mbajtur në Gjykatën Provinciale të Madridit ku u përball me akuzë për falsifikim të të dhënave për përfitime financiare nga shitja e të drejtave të imazhit. Prokurorët kërkuar dy vjet burg dhe gjobë prej 19 milionë eurosh për të. Megjithatë, ylli i Juventusit nuk do të kalojë asnjë ditë në burg, pasi dënimet deri në dy vjet përgjithësisht nuk zbatohen në Spanjë për shkelësit e parë për krime jo të dhunshme. Portugezi ka pranuar marrëveshjen me autoritetet spanjolle dhe, si pasojë, do të paguajë një gjobë rreth 16.5 milionë sterlina.

Boatengi prezantohet te Barcelona

Skuadra e Barcelonës e ka zyrtarizuar transferimin e Kevin-Prince Boateng. 31-vjeçari i bashkohet Barçës në formë huazimi nga Sassuolo. Skuadra spanjolle mund ta blejë futbollistin Boateng për një shumë prej tetë milionë eurosh. "Kjo është një ëndërr, po pres me padurim të luaj për Barcelonën dhe ta bëj maksimumin që ta ndihmoj këtë skuadër. Për shumë lojtarë është ëndërr të luash në këtë klub, por ky është edhe vërtetimi se po punove mirë, ëndrrat mund të bëhen realitet", ka thënë Boatengu.

Demba Ba rikthehet në Evropë

Ish-sulmuesi i Chelsea, Demba Ba, është larguar nga Kina dhe është rikthyer sërish në Evropë. Sulmuesi ka arritur marrëveshje me skuadrën turke Istanbul Basaksehir. Demba Ba, përveç Shanghai Shenhua, ka luajtur edhe për këto klube: Rouen, Mouscron, Hoffenheim, West Ham United, Newcastle United, Chelsea, Beshiktash dhe Goztepe.

Veteli pret shumë nga Mick Schumacheri

Sebastian Vettel beson se Mick Schumacher, i biri i legjendës së Formulës 1, Michael, mund të bëhet ngasës i madh i Formulës 1. I biri i legjendës së Formulës 1, Michael, do të kalojë në Formula 2 këtë sezon pasi ka nënshkruar kontratë me ekipin Prema. Ai është tashmë në radar të Formulës 1 me Ferrarin që synon ta angazhojë atë në akademinë e ngasësve. Veteli ndërkohë e pati mundësinë ta shihte Schumacherin në aksion nga afër gjatë fundjavës që shkoi kur të dy garuan për ekipin e Gjermanisë në "Race of Champions". I pyetur nëse Schumacheri mund të bëhet yll në të ardhmen, Veteli u përgjigj: "Mendoj se duhet t'i japim kohë. Ai është në presion të madh, por ne duhet t'i japim kohë që t'i bëjë gjërat dhe do të shohim se çfarë do të ndodhë".


Përfundon sezoni për Bellerinin

Ka përfunduar sezoni për mbrojtësin e Arsenalit, Hector Bellerin, i cili u lëndua në ndeshjen e fundjavës ndaj Chelsea (2-0). Pas analizave të bëra, është konstatuar se Bellerini e ka pësuar një këputje të ligamentit të kryqëzuar të gjurit, një dëmtim ky ndër më të rëndit në sport, pasi periudha e riaftësimit varion nga 6 muaj deri në një vit. Në mungesë të Bellerinit në krahun e djathtë të mbrojtjes pritet të luajë Stephan Lichtsteiner, i cili gjatë verës u transferua nga Juventus.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovec/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 16 dhe 17, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-31/2008", dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-13/2012, neni 6 të Ligjit Nr.05/L-009, për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01Nr. 1507 i datës 30.04.2018 Komisioni komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec shpall:

KONKURS

Për 4 (katër) Anëtarë të Bordit të Drejtorëve në ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Kandidatët për t'u zgjedhur për anëtar të bordit të ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec, duhet të kenë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të Ligjit Nr. 03/L-087, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet Publike, të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-13/2012, neni 6 të Ligjit Nr.05/L-009, për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 si vijon:

- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara:
 - në administrim të biznesit;
 - financa korporative;
 - financa;
 - menaxhim të thesarit;
 - banka;
 - konsulencë në biznes;
 - industri ose
 - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjes Publike Qendrore.

KUSHTET

Një person ka të drejtë të shërbejë si Anëtar i Bordit të ndërmarrjes publike lokale, "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec, nëse:

- Nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Nuk ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

Kandidati nuk mund të zgjidhet anëtar në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale, nëse:

- Aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saj;
- Ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjes Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike) i cilitdo person që i takon cilëndo nga kategoritë e sipërpërmendura.
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikt të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutine, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmblushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjes Publike.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtorë në Bordet e Ndërmarrjes Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Letër motivimin

- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësojë personalisht deklaratën nën betim, me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohet në Qendrën për shërbime të qytetarëve në Komunën e Rahovecit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 045 / 291 - 395
Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i anëtarëve të Bordeve të Ndërmarrjes Publike do të bëhet në bazë të nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit nga popullata jo-shumicë dhe të interesuarit që do të përfaqësojnë interesat e Komunës ku NP vepron, që të aplikojnë në konkursin për drejtorë të Bordeve të Ndërmarrjes Publike.

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës 22.01.2019 deri më datën 22.02.2019).

Komisioni komunal i Aksionarëve

Rexhep Oruqi

Hanalora Hoti

Përparim Krasniqi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "BORA - CLEAN" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit: 810097255 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "BORA - CLEAN" D.o.o. u Prishtinu, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810097255, I ujdno imenovao Likfidatora o sprovedjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "BORA - CLEAN" L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business with registry: 810097255, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDEJTËSISË
 VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
 GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
**Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
 (AKPPM)**
 Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
 Kosova Medicines Agency (KMA)



Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, **Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale** shpall këtë:

K O N K U R S

1. Titulli i punës: Tre (3) Zyrtar/e të Lartë për shqyrtim të dokumentacionit shkencor

Referenca : 01/2019
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e vëqanta deri në (6) muaj
Koeficienti 8
Orari i punës : 40 orë në javë
Mbikëqyrësi : Drejtori i Departamenti i Autorizim Marketingut
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi/Përgjegjësia e vendit të punës:

Qëllimi është kontrollimi i dokumentacionit të dosjeve të Produkteve Medicinale me emra të mbrojtur dhe atyre gjenerik që hyjnë në tregun e Kosovës duke ju nënshtruar të gjitha procedurave Ligjore në mënyrë që të mbrohet shëndeti i popullatës. Shqyrtim dhe vlerësim i dokumentacionit të plotë shkencor të dorzuar nga ana e kompanive farmaceutike me qëllim të regjistrimit të produkteve të tyre. Respekton zbatimin e Ligjit mbi produkte dhe pajisje medicinale dhe aktet nënligjore të nxjerrura nga ky Ligj.

Detyrat kryesore:

- Shqyrtimi i dokumentacionit të plotë shkencor të produktit medicinal duke i respektuar procedurat sipas Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe akteve nënligjore dhe UA që dalin nga ky Ligj;
- Koordinimi me palë dhe rekomandimet ligjore dhe procedurale që duhet të aplikohen për regjistrimin e Produkteve Medicinale
- Raportimi javor i evaluimit të punëve tek Drejtori i Departamentit;
- Raportimi javor dhe mujor mbi aktivitetet e ndërmarra pranë mbikëqyrësit;
- Bashkpunimi me stafin profesional dhe ndihmës në kuadër të Departamentit të Autorizim Marketingut, I.Z.KKPM dhe Departamenteve tjera pranë AKPPM-së;
- Kontrollimi dhe miratimi i fletëudhëzuesve për pacientë dhe i SPC (Summary of Product Characteristics)
- Përditësimi i të dhënave lidhur me produkte medicinale në sistem Barnatari
- Kontrollimi dhe vlerësimi i ATC kodeve
- Sistemimi dhe sigurimi i dosjeve sipas rregullave të Departamentit që në raste të posaqme qasja në dokumentacion të jetë më e lehtë
- Detyra dhe përgjegjësi tjera të kërkuara dhe të caktuara nga mbikëqyrësi: sa i përket procedurës për aplikim, evaluim, ripërtitje, variacione, revidime dhe menaxhimi i takimeve të KVPPM-së sipas UA në fuqi dhe përgatitja e raporteve javore dhe raportimi tek Drejtori i Departamentit

Aftësitë:

- Aftësi organizative për punë në rrethana të ndryshme;
- Aftësi komunikuese me palë
- Njohuri në lëmin e politikave rregullative dhe Ligjit në fuqi;
- Njohuri fundamentale farmakologjike, toksikologjike, farmako-kinetike dhe farmako-dinamike si dhe paraklinike dhe klinike
- Aftësi për shqyrtim të CTD dokumentacionit;

Kualifikimi dhe përvoja:

- Diplomë Universitare në Farmaci, Kimi, Biologji aplikative, Biologji.
- Njohja e gjuhëve zyrtare dhe gjuhës angleze. Përvojë pune e preferuar 3 vite.

2. Titulli i punës: Nje (1) zyrtar i IT-së për çështje të Autorizim Marketingut

Referenca : 01/2019
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e vëqanta deri në (6) muaj
Koeficienti 7
Orari i punës : 40 orë në javë
Mbikëqyrësi : Drejtori i Departamenti i Autorizim Marketingut
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi/Përgjegjësia e vendit të punës:

Evidentimi dhe listimi i Produkteve Medicinale me Certifikata që hyjnë në tregun e Kosovës duke ju nënshtruar të gjitha procedurave Ligjore. Përgjegjës për ngarkimin e të dhënave në sistem Barnatari dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga ana e kompanive farmaceutike me qëllim të rezhistrimit të produkteve të tyre. Mbikëqyrës IT në departamentin Marketing Autorizim

Detyrat kryesore:

- Regjistrimi i të dhënave në sistem Barnatari në modulën e AM-së
- Përditësimi i të dhënave lidhur me produkte medicinale në sistem Barnatari
- Përgatitja e listave të produkteve medicinale të regjistruara
- Klasifikimi i certifikatave MA, RMA, URMA, PMA

- Ofrimi i ndihmës për zyrtarin e TI-së dhe ndihmon stafin në zgjedhjen e problemeve profesionale në sistem Barnatari
- Vendosja dhe verifikimi i MA, RMA, URMA, PMA në sistem barnatari sipas Certifikates se AM
- Zgjedhja e problemeve teknike eventuale në DAM
- Detyra shtese sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe Drejtorit të DAM-së në lidhje me qëllimin e vendit të punës

Aftësitë:

- Aftësi organizative për punë në departament Marketing Autorizim;
- Aftësi komunikuese me palë
- Njohuri në lëmin e IT-se për zgjedhje të problemeve;
- Aftësi për zgjidhje të problemeve të ndeshura gjatë evidentimit të produkteve në sistem barnatari;

Kualifikimi dhe përvoja:

- Certifikuar për IT
- Përvojë pune e preferuar 2 vite si IT, Databasse, Software, Hardware

3. Titulli i punës: Nje (1) zyrtar/e i lartë për garantimin e cilësisë të produktëve medicinale

Referenca : 01/2019
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e vëqanta deri në (6) muaj
Koeficienti : 8
Orari i punës : 40 orë në javë
Mbikëqyrësi : Drejtori i Laboratorit të Kontrollit të Cilësisë
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës

Për ngritje të kapacitetit të Laboratorit të Kontrollit të Cilësisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Analizon dhe kontrollon produktet medicinale të cilat sigurohen nga departamentet përkatëse,
- Evaluan dokumentacionin farmaceutik dhe verifikon metodat analitike për kontrollë të kualitetit,
- Siguron që sistemi i kualitetit është në përputhje me ISO 17025,
- Ofron këshilla profesionale mbi kontrollën e kualitetit të produkteve medicinale.
- Zhvillimi dhe validimi i metodave instrumentale analitike.
- Përcaktimi i friabilitetit, fortësisë, dezintegritimit të formave të forta dozuese, i shpejtësinë e tretjes dhe profilit të çlirimit të produktit final,
- Përpilon fletë-rezultatit mbi kontrollimin fiziko-kimik të kualitetit,
- Përpilon fletë-rezultatit mbi kontrollimin farmakologjik të kualitetit,
